

VENDIM
Nr.548, datë 7.7.2010

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.868, DATË 12.12.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E INSPEKTORATIT
NDËRTIMOR E URBANISTIK KOMBËTAR”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 2 e vendimit nr.868, datë 12.12.2007 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë si vijon:

“2. Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar e shtrin veprimtarinë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Struktura dhe organika e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit përgjegjës në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha